

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, në lëndën penale kundër të akuzuarve L. D. dhe B. D., që të dy nga fshati R., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.1752/2015 të datës 31.05.2018 për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me datë 01.06.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.1752/2015 të datës 31.05.2018, andaj gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të akuzuarit:

1.L. D., i biri i I. dhe V., e gjinisë N., i lindur me dt...., në fshatin R., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani banon, i martuar, me profesion bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, kinse më parë i padënuar.

2.B. D., i biri i L. dhe H., e gjinisë L., i lindur me dt...., në fshatin R., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani banon, i martuar, me profesion bukëpjekës, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, kinse më parë i padënuar.

JANË FAJTORË

S e p s e:

Me dt. 21.12.2015, rreth orës 13:30 min., në fshatin K. e M., Komuna e Rahovecit, në bashkëkryerje në mënyrë të kundërligjshme e privojnë nga liria personin tjetër. Ashtu që ditën kritike në tregun e fshatit K. e M., privojnë nga liria të dëmtuarin V. H. duke e futur në

veturën e tyre të markës “Golf IV”, me targa të regjistrimit ..., të dëmtuarin e dërgojnë në fshatin R., Komuna e Prizrenit, respektivisht tek varrezat e këtij fshati dhe pasi që e zbresin nga vetura, të dëmtuarit ia lidhin duart me një spagë. Ndërkohë përmes telefonit e kontaktojnë vëllain e të dëmtuarit M. H., duke kërcënuar dhe kushtëzuar që në shkëmbim të lirisë të vëllait të tij të ia u kompenzojë borxhin në shumë prej 600 euro, me ç’rast të dëmtuarit i shkaktojnë ankth dhe pasiguri.

Këso dore kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje, privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 46, 73, 196 par. 1 të KPRK-së, nenit 365 dhe 493 të KPPK-së, të akuzuarit i’u shqipton:

D Ë N I M M E G J O B Ë

Të akuzuarit **L. D.**, në shumën prej **pesëqind (500) euro**, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguaj në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit **B. D.**, në shumën prej **pesëqind (500) euro**, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguaj në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mundë të paguajnë gjobën sipas nenit 46 të KPRK-së, e njëjta do të i’u zëvendësohet në dënim me burgim për secilin të akuzuar në kohëzgjatje prej njëzetepesë (25) ditëve, duke llogaritur çdo ditë të burgimit me nga njëzetë (20) euro.

I dëmtuari V. (B.) H. nga fshati K. e M., Komuna e Rahovecit, udhëzohet që kërkesën pasurore–juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile.

Të akuzuarit obligohen që t’i paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50 euro në mënyrë solidare, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm kësaj gjykate ia ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1752/2015 të datës 31.05.2018, kundër të akuzuarve L. D. dhe B. D., që të dy nga fshati R., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga ana e të akuzuarve.

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë për dhënin e urdhrin ndëshkimor në kuptim të nenit 493 paragrafi 1 të KPPK-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Deklaratat e të pandehurve L. D. dhe B. D. dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me dt. 21.12.2015; deklarata e të dëmtuarit V. H. dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me dt. 21.12.2015 si dhe në Prokurorinë Themelore në Gjakovë me dt. 17.05.2016; deklarata e dëshmitarit M. H. dhënë në Stacionin Policor në Rahovec me dt. 21.11.2015; raporti i oficerit F. C. me nr. KI#7568 të dt. 21.12.2015; raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dt. 22.12.2015; lista e dëshmimeve e dt. 22.12.2015; mjeti me të cilin është kryer vepra penale “Spago”, si dhe foto-dokumentacioni dhe shkresat tjera të bashkangjitur në këtë lëndë, gjykata konstaton se këto prova janë bindëse, të besuara dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, prandaj gjykata të njëjtit i shpalli fajtorë dhe i gjykoi si në dispozitiv.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurën civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallit gjyqësor bazohet në nenin 450 paragrafi 2 nënparagrafi 6 lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - DEGA RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.184/16 me datën 01.06.2018**

Sekr. Juridike

Gjyqtari i vetëm gjykues

Shemsije Shehu

Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimit mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit, për Gjykatën Themelore Gjakovë – Dega Rahovec.